

STATUTI
I
SHOQATËS SHQIPTARE PËR PSIKOTERAPINË

KREU I

Neni 1
Emri, Simboli dhe Vula

- a) Emri i Shoqatës është:
- “Shoqata Shqiptare për Psikoterapinë” (SHSHP)
 - “Albanian Association for Psychotherapy” (AAP)
- b) Simboli i Shoqatës është një drejtkëndësh në të cilin është e vendosur harta e Shqipërisë. Në pjesën e poshtme të drejtkëndëshit kalon një shirit i harkuar ku janë shkruar inicialet e Shoqatës në shqip (SHSHP).
- c) Vula e shoqatës është e përbërë nga dy rrrathë bashkëqendrorë ku në mes të rrethit më të vogël është shkruar me shkronja të mëdha shtypi “SHSHP” dhe në hapësirën ndërmjet dy rrrathëve është shkruar “Shoqata Shqiptare për Psikoterapinë”.

Neni 2
Selia

SHSHP ka selinë e saj në Tiranë në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kulla Jeshile nr.1 Tiranë, Shqipëri. SHSHP është e lirë të krijojë degë të saj në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të SHSHP është e pakufizuar.

Neni 4
Qëllimi dhe Objektivat

SHSHP është një organizatë jo fitimprurëse, e cila ka për qëllim:

1. Zhvillimin e shkencës dhe profesionit të Psikoterapisë në Shqipëri.
2. Sigurimin e standardeve të larta të etikës, të kualifikimit dhe të ushtrimit të psikoterapisë.
3. Të promovojë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e ideve mes profesionistëve dhe organizatave që veprojnë në fushën e Shëndetit Mendor, arsimit, përkrahjes sociale, burimeve njerëzore, etj., duke inkurajuar krijimin e kontakteve me shërbimet përkatëse dhe duke mbështetur kualifikimet dhe kërkimet në disiplinën e psikoterapisë.
4. Të sigurojë standardet e trajnimit dhe praktikës së psikoterapisë nëpërmjet Certifikatës Shqiptare për Psikoterapinë.

Neni 5

Burimet financiare

SHSHP ka burimet financiare të mëposhtme për zhvillimin e veprimtarive të saj:

- a) Kuotat e anëtarësisë.
- b) Fonde, grante dhe donacione të ofruara nga personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, dhe që nuk kushtëzohen nga qëllime politike e synime të tjera që bien në kundërshtim me objektin, qëllimet dhe synimet e SHSHP-së të pasqyruara në statut dhe në dokumentet e themelimit të saj.
- c) Të ardhurat nga veprimtaritë shkencore dhe botuese.
- d) Të ardhura nga shërbimet e vëna në dispozicion nga SHSHP.
- e) Burime të tjera të ligjshme

I gjithë buxheti depozitohet në një llogari të rrjedhshme bankare.

Ndalohet kategorikisht shpërndarja e fitimeve ose përfitimeve financiare dhe materiale si dhe të ardhurave e fitimeve të shoqatës midis anëtarëve të shoqatës apo anëtarëve të organeve drejtuese të saj përveç detyrimeve në formën e pagave, pagesave, shpërblimeve e kompensimeve që rrjedhin nga kontratat ose për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe për llogari të shoqatës.

Shoqata bën shpenzime vetëm për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë së saj. Buxheti përdoret për aktivitete të shoqatës që miratohen nga Këshilli Drejtues. Aprovimi për çdo veprim financiar në kuadrin e projekteve që ndërmerren nga anëtarët e shoqatës, merret nga Këshilli Drejtues.

Dokumentacioni përkatës firmoset nga Kryetari dhe Financieri i Shoqatës.

Neni 6

Anëtarësimi në SHSHP

1. Anëtarë të SHSHP-së mund të jenë personat fizikë, arsimimi i të cilëve i përket shkencave humane (psikoterapeutike, mjekësore, psikologjike, sociale, pedagogjike) si edhe personat juridikë, veprimtaria e të cilëve shtrihet në fushat e lartpërmendura. SHSHP ka tre lloje të anëtarësisë:

a. **Anëtarë me të drejta të plota:**

a.1 Profesionistë që kanë përfunduar kualifikimin e plotë në një nga shkollat psikoterapeutike dhe që janë mbajtës të certifikatës shqiptare të psikoterapisë (CSHP) apo certifikatës europiane të psikoterapisë (ECP);

a.2 Profesionistë që kanë të paktën një diplomë master në një nga disiplinat e mësipërme, por që kanë përfunduar të paktën 50% të kualifikimit në psikoterapi dhe janë në proces edukimi.

b. **Anëtarë me të drejta të pjesshme:**

b.1 Individë që kanë të paktën një diplomë master në një nga disiplinat e mësipërme nga një institucion akademik i akredituar në Shqipëri dhe në Kosovë, dhe që kanë eksperiencë të pjesshme klinike/psikoterapeutike, por nuk disponojnë CSHP-në ose ECP-në;

b.2 Profesionistë të kualifikuar të shëndetit mendor që jetojnë jashtë

Shqipërisë dhe që kanë eksperiencë klinike dhe psikoterapeutike;
b.3 Studentë të nivelit universitar ose master në një nga disiplinat e mësipërme që kanë interes në disipinën e psikoterapisë.

c. Anëtarë organizativë:

c.1 Organizata që punojnë në fushën e psikoterapisë dhe që pranojnë 'Deklaratën e Strasburgut mbi Psikoterapinë' të vitit 1990.

2. Anëtarët e SHSHP-së përkrahin dhe punojnë për çështje të cilat përputhen me qëllimet dhe objektivat e SHSHP-së. Pranimi në Shoqatë bëhet me kërkesën me shkrim të vetë personit. Emri i tij/saj regjistrohet në Librin e Anëtarëve të Shoqatës.
3. Të gjitha aplikimet për anëtarësim shqyrtohen nga Komisioni i Anëtarësimit.
4. Anëtarët e niveleve të ndryshme janë të detyruar të paguajnë nivele të ndryshme kuotash vjetore të anëtarësimit, vlerat e të cilave përcaktohen nga Mbledhja e Përgjithshme.
5. E drejta e votës :
 - a. Anëtarët me të drejta të plota individuale kanë të drejtë të një vote në Mbledhjen e Përgjithshme.
 - b. Anëtarët organizativë kanë të drejtën e një vote në Mbledhjen e Përgjithshme për çdo 10 anëtarë të tyre por jo më shumë se 3 vota.
 - c. Anëtarët me të drejta të pjesshme mund të marrin pjesë në Mbledhjen e Përgjithshme si vëzhgues.
 - d. Anëtarët me të drejta të pjesshme përfitojnë lehtësira për pjesëmarrje në aktivitetet e organizuara nga SHSHP.
6. Çdo anëtar pajiset me kartë anëtarësie në SHSHP.

Neni 7

Përfundimi i anëtarësisë

1. Një anëtar mund të përjashtohet nga SHSHP për qëndrim dhe sjellje të dëmshme ndaj objektivave dhe qëllimeve të SHSHP-së ose kur ai nuk i përmbahet statutit apo rregullave të SHSHP-së.
2. Përjashtimi i një anëtari vendoset nga Mbledhja e Përgjithshme me rekomandim të Këshillit Drejtues, rekomandim në të cilin paraqiten arsyet ku bazohet propozimi.
3. Një anëtar konsiderohet se është i rregullt në qoftë se ka paguar plotësisht brenda afateve të gjitha kuotat e kontributet e anëtarësisë.
4. Një anëtar mund të japë dorëheqjen nga SHSHP në çdo kohë nëpërmjet dorëzimit të dorëheqjes së tij me shkrim në selinë e SHSHP-së.
5. Përgjegjësia e anëtarit që largohet është e njëjtë me atë të anëtarëve të tjerë të SHSHP-së për veprimtarinë e kryer deri në çastin e largimit. Anëtari që largohet duhet të shlyejë paraprakisht të gjitha detyrimet që ka ndaj SHSHP-së. Çdo mosmarrëveshje në këtë drejtim, nëse nuk zgjidhet me mirëkuptim, zgjidhet në gjykatë.

KREU II

ORGANET E SHSHP-së

Neni 8

Organet e SHSHP-së janë:

- a. Mbledhja e Përgjithshme
- b. Këshilli Drejtues

- c. Komisioni i Anëtarësimit
- d. Komisioni i Etikës
- e. Komisioni i Standardeve të Trajnimit dhe Certifikimit

Neni 9 **Mbledhja e Përgjithshme**

1. Në Mbledhjen e Përgjithshme kanë të drejtë të marrin pjesë të gjithë anëtarët e SHSHP-së.
2. Mbledhja e Përgjithshme:
 - a) miraton statutin e SHSHP-së dhe aktet e saj, si dhe ndryshimet e tyre;
 - b) miraton fushat dhe programet e veprimtarisë së SHSHP-së;
 - c) zgjedh Këshillin Drejtues të SHSHP-së me votim të fshehtë;
 - ç) mbikqyr aktivitetet e SHSHP-së, shqyrton çështjet ekonomike të saj, dokumentet e saj financiare, si dhe pasuritë dhe pronat e saj;
 - d) vendos në lidhje me pranimin ose përjashtimin e anëtarëve dhe për çdo çështje tjetër që nuk është lënë në kompetencë të ndonjë organi tjetër të SHSHP-së;
 - e) miraton aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e SHSHP-së dhe shpenzimet për vitin e ardhshëm.
 - f) nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë, organizimit dhe strukturës së SHSHP-së;
 - g) vendos mbi shpërndarjen ose mbylljen e SHSHP-së.
 - h) zgjedh Kryetarin e SHSHP-së, Sekretarin, Nënkryetarin, Financierin (personin përgjegjës për thesarin) dhe anëtarët e Komisionit të Anëtarësimit, Komisionit të Etikës dhe Komisionit të Standardeve të Trajnimit dhe Certifikimit me shumicë absolute votash.

Neni 10 **Mbledhja e Përgjithshme dhe Vendimmarrja**

1. Mbledhja e Përgjithshme thirret nga Këshilli Drejtues, Kryetari i SHSHP-së ose me kërkesën e të paktën 1/5 së anëtarëve të SHSHP-së.
2. Mbledhja e Përgjithshme thirret rregullisht të paktën një herë në vit.
3. Mbledhja e Përgjithshme zhvillohet kur në të marrin pjesë jo më pak se dy të tretat e anëtarëve. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që janë të pranishëm në Mbledhjen e Përgjithshme.

Neni 11 **Këshilli Drejtues**

1. SHSHP drejtohet dhe administrohet nga një Këshill Drejtues (Këshilli). Këshilli përbëhet nga 7 anëtarë dhe nga një përfaqësues nga organizatat anëtare në SHSHP. Këshilli ka funksione ekzekutive.
2. Këshilli Drejtues përbëhet nga Kryetari, Nënkryetari, Sekretari, Financieri dhe drejtuesit e Komisionit të Anëtarësimit, Komisionit të Etikës dhe Komisionit të Standardeve të Trajnimit dhe Certifikimit dhe nga përfaqësuesit e organizatave anëtare.
3. Anëtarë të Këshillit Drejtues zgjidhen ata individë, të cilët janë anëtarë të SHSHP-së prej të paktën 4 vitesh si dhe janë të regjistruar në Regjistrin European të Psikoterapistëve, ose ata që janë të deleguar nga organizatat anëtare të SHSHP-së.
4. Anëtarët e Këshillit Drejtues zgjidhen për një afat prej 2 vjetësh me të drejtë rizgjedhjeje.
5. Këshilli Drejtues zgjedh dhe shkarkon me votim të fshehtë Kryetarin, Nënkryetarin, Sekretarin dhe Financierin.

6. Një person nuk mund të mbajë më shumë se një post.
7. Një anëtar i Këshillit mund të japë dorëheqjen nga Këshilli në çdo kohë duke dorëzuar dorëheqjen e tij/të saj me shkrim Këshillit të SHSHP-së.

Neni 12

Funksionet e Këshillit Drejtues

Këshilli Drejtues drejton të gjithë veprimtarinë e SHSHP-së në periudhën midis dy Mbledhjeve të Përgjithshme që rinovojnë Këshillin në përputhje me statutin dhe orientimet e Mbledhjes së Përgjithshme.

1. Këshilli përgatit buxhetin e SHSHP-së dhe zërat e buxhetit dhe ndryshimet në të.
2. Këshilli aprovon statutin fillestar.
3. Këshilli aprovon strukturën dhe personelin e SHSHP-së dhe përcakton pagat dhe shpërblimet në bazë shërbimesh e të gjithë të punësuarve të SHSHP-së.
4. Këshilli harton programin e aktiviteteve të SHSHP-së.
5. Këshilli miraton deklaratat e SHSHP-së.
6. Këshilli cakton mënyrat dhe përfaqësuesit e SHSHP-së për aktivitete të ndryshme që organizohen brenda dhe jashtë vendit.
7. Këshilli koordinon marrëdhëniet me organizma dhe organizata të tjera.
8. Këshilli bën pranimin dhe përjashtimin e anëtarëve të rinj.
9. Këto si dhe ndryshimet e statutit të propozuara nga Këshilli janë subjekt diskutimi, miratimi apo mosmiratimi nga Mbledhja e Përgjithshme.
10. Nëse nevojitet, Këshilli Drejtues mund të hartojë një rregullore të brendshme për rregullimin e hollësishtëm të funksionimit të SHSHP-së, me kusht që të mos bjerë ndesh me asnjë nga pikat e statutit të miratuar nga Mbledhja e Përgjithshme.

Neni 13

Rregullat e Funksionimit të Këshillit Drejtues

1. Këshilli mbledhet rregullisht të paktën një herë në çdo gjashtë muaj. Mbledhjet e Këshillit thirren nga Kryetari, ose nga 1/2 e anëtarëve të Këshillit.
2. Sekretari dërgon nëpërmjet e-mailit rendin e propozuar të çdo mbledhje tek anëtarët e Këshillit të paktën dy javë përpara mbledhjes ose, në qoftë se është një mbledhje e jashtëzakonshme, sa më shpejt që të jetë e mundur përpara mbledhjes. Çdo çështje e paparashikuar në rendin e ditës të një mbledhje të jashtëzakonshme e të dërguar nga Sekretari mund të shqyrtohet, vetëm në rast se gjithë anëtarët e Këshillit japin pëlqimin e tyre.
3. Mbledhja e Këshillit është e vlefshme në qoftë se janë të pranishëm jo më pak se 1/2 e anëtarëve të tij.
4. Këshilli i merr vendimet me shumicë votash të anëtarëve të tij, të cilët janë personalisht të pranishëm.
5. Procesverbali mbahet në çdo mbledhje të Këshillit dhe ruhet në selinë e SHSHP-së.
6. Çdo vendim i Këshillit, i cili bie në kundërshtim me dispozitat e këtij statuti, është i pavlefshëm.

Neni 14

Kryetari dhe Nënkryetari i Këshillit Drejtues

1. Kryetari i Këshillit është në të njëjtën kohë dhe Kryetari i SHSHP-së.
2. Kryetari dhe në mungesë të tij Nënkryetari si dhe Sekretari janë përfaqësuesit zyrtarë të SHSHP-së.
3. Kryetari i Këshillit kryeson mbledhjet e Këshillit dhe Mbledhjet e Përgjithshme.
4. Kryetari bashkëpunon me Sekretarin në çdo çështje dhe nënshkruan të gjithë korrespondencën e përgjithshme.

Neni 15 Financieri

1. Financieri i SHSHP-së mbikqyr të gjitha shpenzimet, ashtu si dhe menaxhimin e parave dhe pasurive të SHSHP-së dhe është përgjegjës që raportet financiare të mbahen në rregull dhe në përputhje me kërkesat e aplikueshme ligjore.
2. Financieri shqyrton dhe mban llogaritë, faturat dhe çdo shpenzim të aprovuar nga Këshilli.
3. Financieri i raporton rregullisht Këshillit Drejtues.

Neni 16 Sekretari

1. Sekretari i SHSHP-së mban një raport tërësor të procedurave të Mbledhjes së Përgjithshme, mbledhjeve të Këshillit Drejtues dhe të aktiviteteve të ndryshme të SHSHP-së.
2. Sekretari mban vulën dhe regjistrin e SHSHP-së.
3. Sekretari shpërndan axhendën (planin e punës) së Mbledhjes së Përgjithshme dhe të mbledhjeve të Këshillit Drejtues.
4. Sekretari është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e SHSHP-së me përjashtim të dokumenteve financiare.
5. Sekretari është përgjegjës për korrespondencën e SHSHP-së.
6. Së bashku me Kryetarin, Sekretari përfshihet në koordinimin e programeve të SHSHP-së.

Neni 17 Komisioni i Anëtarësimit

Komisioni i Anëtarësimit:

1. Shqyrton aplikimet për anëtarësim si dhe i propozon Këshillit Drejtues këto aplikime.
3. Shqyrton dorëheqjet e anëtarëve të SHSHP-së dhe i paraqet ato pranë Këshillit Drejtues.
4. Komisioni përbëhet nga 3 anëtarë.
5. Anëtarë të këtij komisioni mund të jenë dhe anëtarë të tjerë të Këshillit Drejtues, por drejtuesi i i këtij komisioni nuk mund të ketë një pozicion tjetër në Këshillin Drejtues.
6. Anëtarët e këtij komisioni, që janë në konflikt interesi me çështjen nën shqyrtim, zëvendësohen posaçërisht për shqyrtimin e kësaj/këtyre çështjeje/çështjesh.
7. Komisioni mbledhet të paktën një herë në tre muaj.

Neni 18 Komisioni i Etikës

Komisioni i Etikës:

1. Siguron që anëtarët e SHSHP-së i përmbahen standardeve etike sipas kodit etik të SHSHP/EAP-së të pranuar nga të gjithë anëtarët si pjesë e procedurës së anëtarësimit.
2. Shqyrton të gjitha ankesat mbi shkeljet e mundshme të etikës nga anëtarët e SHSHP-së.
3. Komisioni përbëhet nga 3 anëtarë.

4. Anëtarë të këtij komisioni mund të jenë dhe anëtarë të tjerë të Këshillit Drejtues, por drejtuesi i këtij komisioni nuk mund të ketë një pozicion tjetër në Këshillin Drejtues.
5. Anëtarët e këtij komisioni që janë në konflikt interesi me çështjen nën shqyrtim zëvendësohen posaçërisht për shqyrtimin e kësaj/këtyre çështjeje/çështjesh
6. Komisioni mblidhet një herë në tre muaj.

Neni 19

Komisioni i Standardeve të Trajnimit dhe Certifikimit

Komisioni i Standardeve të Trajnimit dhe Certifikimit:

1. Shqyrton standardet profesionale psikoterapeutike dhe kriteret e trajnimeve në fushën e psikoterapisë të ndërmarra nga SHSHP apo anëtarët organizativë të SHSHP-së.
2. Shqyrton dhe i propozon Këshillit Drejtues aplikimet për pajisjen me CSHP të profesionistëve të ndryshëm.
3. Komisioni përbëhet nga 3 anëtarë.
4. Anëtarë të këtij komisioni mund të jenë dhe anëtarë të tjerë të Këshillit Drejtues por drejtuesi i këtij komisioni nuk mund të ketë një pozicion tjetër në Këshillin Drejtues.
5. Anëtarët e këtij komisioni, që janë në konflikt interesi me çështjen nën shqyrtim, zëvendësohen posaçërisht për shqyrtimin e kësaj/këtyre çështjeje/çështjesh.
6. Komisioni mblidhet një herë në tre muaj.

Neni 20

Konflikti i interesave

Çdo anëtar i organit më të lartë vendimmarrës ose ekzekutiv duhet të tërhiqet nga shqyrtimi dhe marrja e vendimit për çdo çështje për të cilën ai ose familjarët e tij kanë interesa të drejtpërdrejta ose të tërthorta ekonomike ose vetjake.

Neni 21

Ndërprerja e veprimtarisë

Shoqata e ndërpret veprimtarinë e saj kur:

1. Numri i anëtarëve zbret më poshtë se ai i grupit nismëtar të saj;
2. Vendoset nga Mbledhja e Përgjithshme e SHSHP-së.

Dispozitat Përfundimtare

Neni 22

Likuidimi

Në rast të shpërndarjes ose mbylljes së aktivitetit të SHSHP-së për njërin nga shkaqet e parashikuara me ligj apo në statut, pasuria e mbetur e SHSHP-së shkon për qëllime bamirësie në favor të përmbushjes së qëllimeve të SHSHP-së të shprehura në këtë Statut. Në rast se shpërndarja do të vendoset nga vetë SHSHP, likuidimi do të realizohet nga likuidatori, i cili do të caktohet me vendim të Mbledhjes së Përgjithshme të SHSHP-së.